



Komuna e Klinës
Kryetari i Komunës
01Nr. *120-1/20* /2020
Klinë, dt.30.07.2020

Duke u bazuar në neni 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, neni 18 të Ligjit për Zyrtaret Publik, nr.06/L-114 e ndërlidhur më nenin 23 të Ligjit të Punës, nr.03/L-212, si dhe duke marrë parasysh propozimin e Drejtorisë së Bujqësisë për zgjatje të orarit të punës pasi që kërkesat për aplikim të fermerëve për subvencione janë të shumta, punë të cilat duhet kryer në afatin e parapare të përcaktuar nga niveli qendror, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt.30.07.2020 mori:

V E N D I M

Për zgjatjen e orarit të punës për nëpunësit e sektorit të Bujqësisë

1. **LEJOHËT**, zgjatja e orarit të punës për nëpunësit e sektorit të Bujqësisë të cilët kanë të bëjnë me kryerjen e shërbimeve fermerëve të cilët aplikojnë për pagesa direkte-subvencione për vitin 2020. Zgjatja e orarit të punës behet duke filluar nga data 30.07.2020 deri në përfundimin e aplikimeve për pagesa direkte. Orët e zgjatjes së orarit të punës bëhen më njoftimin e drejtorisë së Bujqësisë.
2. Arsyeja e zgjatjes së orarit të punës behet më qellim që të gjithë fermerët e interesuar të kenë mundësinë e aplikimit, pasi që afati për aplikim për pagesa direkte është përcaktuar nga ministria.
3. Eprori i drejtpërdrejt autorizon nëpunësit të cilët do të punojnë më orar të zgjatur si dhe përcakton numrin e orëve dhe kohën e orëve jashtë orarit sipas njoftimit të cilin obligohet ta publikoj.
4. Lidhur më çështjen e kompensimeve për punën jashtë orarit do të merret vendim i veçantë në përputhje më raportin e drejtorisë për orët shtesë të nëpunësve.
5. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- DBPZHR;
- Sektori i bujqësisë;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj